

## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Data 07.05.2026

### PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Ndërtim i pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike Faza VI.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT - 71250000-5 Shërbime arkitektonike, inxhinierike dhe gjeodezike**

**Fondi limit i procedurës: 28,082,000** (njëzet e tetë milion e tetëdhjetë e dy mijë) **lekë pa TVSH**, ose 293,960 (dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nentëqind e gjashtedhjetë) euro pa tvsh.

Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 07.05.2026 (95.53 lekë/euro).

1.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

*Nisur nga natyra e shërbimit që do të kryhet, si dhe duke qenë se të gjitha proceset e shërbimit, objekt prokurimi, janë të ndërvarura me njëra tjetrën nga ana funksionale dhe teknike, dhe përbëjnë një proces të integruar inxhinieriko-teknik, është vendosur që procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” të mos kryhet e ndarë në lote. Gjithashtu, mosndarja në lote dhe ofrimi i shërbimit nga një operator ekonomik garantojnë një standart të qëndrueshëm të cilësisë, një nivel të unifikuar, ndarje të saktë të përgjegjësisë, optimizim të kostos dhe ofrimi i çmimeve konkurruese, efikasitet dhe lehtësi në monitorimin dhe zbatimin e kontratës.*

*Ndërtimi dhe përmirësimi i një kornize referuese në fushën e Gjeodezisë përbën një sistem teknik të pandashëm, ku koherenca e metodologjisë, standardizimi i pajisjeve dhe saktësia e përpunimit të të dhënave janë elementë thelbësorë që nuk mund të garantoohen nëse punimet ndahen midis operatorëve të ndryshëm, pasi një ndarje e tillë do të rriste ndjeshëm rrezikun e mospërputhjeve teknike dhe do të cenonte integritetin e të gjithë rrjetit.*

Ndalohet mbeshtetja për seksionin 2.3 të Kapacitetit teknik pasi janë elemente të domosdoshme që AK të krijojë bindjen se OE e realizon me sukses kontratën. Shërbimi për të ndërtuar kornizën referuese Gjeodezike kërkon përvojë të specializuar në matjen gravimetrike të rendit III në pjesën qendrore dhe jugore të Shqipërisë dhe llogaritja e gjeoidit gravimetrik, njohuri të thelluara për koordinatat gjeografike dhe sistemet e referencës që mund të kenë ndryshuar me kohën. Duke qenë se ky shërbim ka rëndësi të veçantë, pronësinë dhe planifikimin urban, ku gabimet mund të kenë pasojë

ligjore kërkohet që në kapacitetet teknike operatori ekonomik të mos mbështetet në subjekte të tjera. Gjithashtu në këtë formë shmangen vonesat që mund të shkaktohen për shkak të koordinimit ndërmjet subjekteve të ndryshme, apo gabimeve në proces si rezultat i mungesës së kontrollit të drejtpërdrejtë.

Bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:** Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshatshmërinë profesionale të ofertuesve.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se e vlera e fondit limit. *Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuar të bilanceve, për vitet financiare (2023, 2024,2025) të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

**Argumentim:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar; të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Vlera e kërkuar është shërben kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë:

- SSH UNI DIN EN ISO 9001- (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), ose ekuivalente/të barazvlefshme.
- ISO/TC 211 – Standardet për Informacionin Gjeohapësinor dhe Gjeomatikën ose ekuivalente/të barazvlefshme.

- SSH UNI DIN EN ISO/IEC 27001- Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit (ISMS) ose ekuivalente/të barazvlefshme.
- SSH UNI DIN EN ISO 45001 – Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose ekuivalente/të barazvlefshme.

Shënim: Certifikatat për standardet ndërkombëtare të përmendura më sipër duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i cili është i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit (në Shqipëri: Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit – DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë të akreditimit të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe Ligji nr.116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se vetëm organet e akredituara mund të lëshojnë çertifikata që vërtetojnë përputhjen me standardet ndërkombëtare.

- Standarti 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi siguron se operatori ekonomik ka një sistem të strukturuar menaxhimi për cilësinë e vazhdueshme të shërbimit objekt prokurimi. Pajisja me këtë standart garanton që proceset e realizimit të shërbimit do të kryhen në mënyrë të kontrolluar, të dokumentuar, duke minimizuar gabimet/neglizhencat gjatë shërbimit *Ky standard është thelbësor për vendosjen e një strukture të qëndrueshme dhe të dokumentuar të cilësisë në të gjitha aktivitetet e projektit, duke përfshirë planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e punimeve teknike. Ai ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me cilësinë e proceseve dhe përmirëson efikasitetin operativ, gjë që është kritike për projekte të ndjeshme si ato që përfshijnë matje gravimetrike dhe GNSS.*
- Standarti 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standardet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë. Është një tregues që operatori mbron punonjësit. *Aktivitetet në terren si rikonucioni, fiksimi, matjet gravimetrike dhe GNSS, përfshijnë ekspozim ndaj risqeve të ndryshme. ISO 45001 siguron një standard për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e rreziqeve të sigurisë për personelin e përfshirë. Kjo është e domosdoshme për të garantuar kushte të sigurt pune dhe për të përmbushur kërkesat ligjore dhe etike.*
- Standarti 27001 mbi Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standardet e kërkuara për reslizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. *Në kushtet kur projekti prodhon dhe menaxhon të dhëna të ndjeshme teknike dhe gjeohapësinore, përfshirë të dhëna referuese kombëtare dhe të ndërlidhura ndërkombëtarisht, është e domosdoshme sigurimi i integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së këtyre të dhënave. ISO 27001 ofron një qasje të strukturuar për mbrojtjen nga rreziqet kibernetike, aksesit i paautorizuar dhe humbja e informacionit.*
- ISO/TC 211 – Standardet për Informacionin Gjeohapësinor dhe Gjeomatikën është vendosur si kriter pasi të dhënat që do të gjenerohen dhe përdoren në këtë projekt janë pjesë e infrastrukturës gjeohapësinore kombëtare dhe ndërlidhen me rrjete dhe sisteme referimi ndërkombëtare (si ITRS/ETRF89). Përputhshmëria me standardet e ISO/TC 211 siguron që të dhënat të jenë të strukturuar, të dokumentuara dhe të shkëmbyeshme në mënyrë të ndërveprueshme me sistemet rajonale dhe evropiane. Kjo është bazë për integrimin teknik dhe institucional në rrjetet ndërkombëtare gjeodezike.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licencë Profesionale të vlefshme, si

më poshtë:

- Licencë – Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike ose një licencë ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi.

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM, Nr.42, datë 16.01.2008) i n dryshuar. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë licencën profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimit, objekt i kontratës të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore. Kategoria e kërkuar e licencës është kërkuar bazuar në natyrën e shërbimit të kërkuar dhe detyrat specifike të përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor përfitues e cila shërben për të rritur besueshmërinë dhe sigurinë që produkti final do të jetë në përputhje me kërkesat dhe objektin ku përfshihen për kryerjen e shërbimeve gjeodezike dhe topografike, duke garantuar kompetencë teknike, përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kredibilitet për realizimin e kontratës në mënyrë të suksesshme.

**2.3.4** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 8 (tetë) punonjës, për shërbimet:

Nr.	Aktiviteti	Numri minimal i punonjësve
1	Rikonicionimi dhe fiksimi i pikave gjeodezike	3
2	Matjet gravimetrike relative	3
3	Matjeve GNSS	2
	Totali minimal i punonjësve	8

si më poshtë:

- 1 (një) Ekspert Gjeodet me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e projektimit të rrjeteve gravimetrik
- 1 (një) Ekspert Gjeolog me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet
- 1 (një) Ekspert me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e matjeve gravimetrike relative tokësore, përpunimit dhe kompesimit të të dhënave gravimetrike
- 1 (një) Ekspert Gjeodet me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet për realizimin e matjeve GNSS (RTK/Statike), përpunim dhe kompesimn e të dhënave
- 1 (një) Ekspert me përvojë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e llogaritjes së gjeoidit gravimetrik
- 3 (tre) Punonjës staf mbështetës

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a. Për Ekspertët Gjeodet:  
dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Inxhinier Gjeodezi (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën e kërkuar.

b. Për Ekspert Gjeolog:

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Inxhinier Gjeologji/Gjeofizikë (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën e kërkuar.

c. Për Ekspert në fushën e matjeve gravimetrike relative tokësore, përpunimit dhe kompesimit të të dhënave gravimetrike:

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Inxhinier Gjeodezi/Gjeofizikë /Gjeomatikë (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën e kërkuar;

d. Për Ekspert në fushën e llogaritjes së gjeoidit gravimetrik:

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Inxhinier Gjeodezi/Gjeofizikë /Gjeomatikë (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën e kërkuar.

e. Për punonjësit staf mbështetës

- -Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme),

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pra që kanë në dispozicion për përmbushjen e kësaj kontrate.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, termave të referencës, proceset e realizimit të shërbimit objekt prokurimi.

Eksperti Gjeodet me në fushën e projektimit të rrjeteve gravimetrik kërkohet për të siguruar realizimin e projektit me saktësi dhe për të pasur një besueshmëri sa më të lartë është i nevojshëm një ekspert përcaktimin e pozicioneve të pikave gjeodezike duke ju referuar kriterëve mbi realizimin e matjeve të ndryshme (GNSS, gravimetrike) me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në ndërtimi e rrjeteve gjeodezike sipas kuptimit të nenit 5, të VKM-së nr. 669, datë 7.8.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si metadatë”, i ndryshuar. Numri i punonjësve është minimal dhe vlerësuar i tillë në përputhje me proceset e punës dhe detyrat që do të kryhen, në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Ekspert Gjeolog eshte kerkuar Për të siguruar mbështejën në realizimin e projektit në fushën e gjeologjisë ose gjeofizikës pasi ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin e parametrave fizikë të formacioneve gjeologjike në Republikën e Shqipërisë në funksion të përcaktimit të pozicionit të përshtatshëm të pikave gravimetrike).

Ekspert në fushën e matjeve gravimetrike relative tokësore, përpunimit dhe kompesimit të të dhënave gravimetrike Për të siguruar realizimin cilësor dhe me saktësi të këtij lloj projekti, ku peshën më të madhe e mbajnë matjet gravimetrike relative është i domosdoshëm një ekspert bazuar tek natyra e matjeve komplekse gjeodezike

Ekspert Gjeodet për realizimin e matjeve GNSS (RTK/Statike), përpunim dhe kompesimn e të dhënave eshte kerkuar Për të siguruar realizimin e matjeve GNSS me saktësi dhe për të pasur një besueshmëri sa më të lartë per kryerjen e shrbimit objekt kontrate per kryerjen e matjeve GNSS në rrjetet gjeodezike sipas kuptimit te nenit 5, të VKM-së nr. 669, datë 7.8.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si metadatë”, i ndryshuar.

Ekspert në fushën e llogaritjes së gjeoidit gravimetrik eshte kerkuar Për të siguruar realizimin e llogaritjes së gjeoidit gravimetrik per kete arsye është i domosdoshëm një ekspert bazuar dhe tek natyra e matjeve komplekse gjeodezike.

Kërkesa për paraqitjen e stafit mbështetës prej 3 (tre) personash është vendosur me qëllim garantimin e kapaciteteve të nevojshme teknike dhe organizative për realizimin korrekt dhe në kohë të objektit të kontratës. Duke marrë në konsideratë natyrën dhe volumin e shërbimeve që do të kryhen, disponimi i këtij stafi konsiderohet i domosdoshëm për sigurimin e vazhdimësisë së punës, mbulimin e proceseve mbështetëse dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore sipas standardeve të kërkuara. Kjo kërkesë është në raport të drejtë me objektin e prokurimit, nuk krijon kufizim të konkurrencës dhe shërben për të vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Me anë të kriterëve të mësipërme kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar matjeve gjeodezike të ndryshme, si matjet gravimetrike, matjet GNSS, përpunimin dhe vlersimin e tyre si dhe llogaritjen e gjeoidit gracimetrik, OE u kërkohen te kene ekspert që të kenë njohuri specifike në realizimin e aktiviteteve të përcaktuar në specifikime teknike (projekt), në funksion të realizimit me sukses të këtij projekti.

### 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të të dëshmojë se disponon mjete dhe pajisje teknike si më poshtë:

Lloji i makinerive/pajisjeve	Sasia
Automjete	2 copë
Pajisje Gravimetrike (Gravimetër Relativ)	2 copë
Pajisje pozicionimi (Marrës GNSS)	2 copë
Instrumenta ndihmes	

Për pajisjet/mjetet e mësipërme duhet të paraqesë:

- dokumentacion për pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- Leja e qarkullimit të mjetit, Akt – kolaudimi, Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet, Foto të mjeteve ku të duket qartë targa dhe sinjalistika përkatëse.
- deklaratë për disponueshmërinë e tyre gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

*Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset në përputhje me pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 4/ç e nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Qëllimi është të garantohet se operatori ekonomik disponon logjistikën dhe kapacitetet teknike për të realizuar aktivitetet në terren dhe për të përmbushur kërkesat teknike të kontratës. Duke marrë në konsideratë faktin se shërbimi objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër elementet e tij edhe levizjen në territore të ndryshme të shqiperisë qendrore dhe jugore është i domosdoshëm disponimi i automjeteve. Përsa i përket mjeteve të punës ato janë thelbësore për realizimin e shërbimit objekt kontrate të cilat janë të lidhura ngushtë me proceset për zhvillimin e këtij shërbimi si dhe me ekspertet/punmonjesit e kërkuar me lart.

**2.3.6** Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë që stafi i deklaruar për përmbushjen e shërbimeve të jetë i disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 4/ç nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se stafi do të jete i disponueshëm gjatë gjithë kohës me qëllim zbatimin me sukses të kontratës.

**2.3.7** Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se do të realizojnë shërbimin sipas kërkesave dhe specifikimeve të kërkuara përkatësisht nga Autoriteti Kontraktor ASIG.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 4/ç nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të realojnë shërbimin e kërkuar me lart si dhe cdo specifikim tjetër i kërkuar nga AK përfituese me qëllim zbatimin me sukses të kontratës pasi janë elemente të domosdoshëm në proceset për realizimin e projektit final.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, termat e referencës për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “**ASIG**”, Për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar,